

DEPARTAMENTI



JURIDIK  
DHE  
I PERSONELIT

BANKA E SHQIPËRISË

Në përbërje të këtij departamenti janë dy sektorë kryesorë: Sektori Juridik dhe Sektori i Burimeve Njerëzore në zbatim të ushtrimit të dy funksioneve kryesore.

Në vitin 1992 Banka e Shqipërisë kishte dy juristë, atëherë nën emërtimin “këshilltarë ligjorë”, jo të grupuar në një njësi juridike të mirëfilltë, por të atashuar pranë Kabinetit të Guvernatorit. Në të njëjtën kohë në Bankën e Shqipërisë kishte katër specialistë të Departamentit të Personelit.

Në vitet 1994-’95 filloi funksionimin Sektori i Shërbimit Juridik, me katër juristë dhe një jurist të atashuar pranë Departamentit të Mbikëqyrjes. Më pas, në vitin 1996, një jurist kaloi në Departamentin e Administrimit. Departamenti i Personelit mbeti me po kaç specialistë.

Në vitin 1998 Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi strukturën e re të bankes, e cila bënte një ndarje dhe mirëorganizim të këtyre dy strukturave në dy njësi të veçanta, në nivel departamenti: Departamenti Juridik dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore.

Në tetor të vitit 2000, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi strukturën e re të saj, në të cilën u pasqyrua edhe statusi i mëvonshëm i Departamentit Juridik dhe atij të Burimeve Njerëzore, duke u shkrirë në një të vetëm: Departamenti Juridik dhe i Burimeve Njerëzore, me varësi të drejtpërdrejtë nga Zëvendësguvernatori i Dytë.

Brendapërbrenda këtij departamenti është bërë ndarja e detyrave dhe e funksioneve të sektorëve. Kështu, Sektori Juridik ka këto detyra dhe funksione kryesore :

- Siguron që të gjitha aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë të nxirren në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Tërheq vëmendjen për shkelje ose për cënim të ligjit, të akteve nënligjore apo të marrëveshjeve të përfunduara nga Banka e Shqipërisë.
- Kërkon zbatimin e njëllajtë dhe të përpiktë të të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorët, nëpunësit, punonjësit, inspektorët e brendshëm dhe të jashtëm, agjentët dhe korrespondentët e Bankës së Shqipërisë.
- Asiston me ndihmë juridike drejtpërsëdrejti Këshillin Mbikëqyrës me kërkesën e tij.
- Asiston me ndihmë juridike drejtpërsëdrejti Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorët.
- Merr pjesë drejtpërdrejt apo indirekt në negociimin, në hartimin dhe në përfundimin e kontratave dhe të marrëveshjeve që Banka e Shqipërisë do të lidhë si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Gjithashtu, Sektori Juridik mund të lëshojë “opinione ligjore” në zbatim të tyre.
- Bën interpretimin juridik të akteve ligjore, nënligjore, të kontratave dhe të marrëveshjeve që përfundohen nga Banka e Shqipërisë.
- Asiston departamentet e tjera për përgatitjen e akteve të tjera që paraqiten për miratim në organet drejtuese të Bankës së Shqipërisë.
- Propozon ndryshime, plotësime dhe alternime në aktet ligjore dhe nënligjore, normative dhe jonormative për ekonominë dhe për financën.
- Përfaqëson Bankën e Shqipërisë në organet e drejtësisë.
- Kërkon ndihmë juridike suplementare jashtë Bankës së Shqipërisë.
- Asiston me ndihmë juridike bankat e nivelit të dytë.
- Përpunon dhe konfirmon korrespondencën brenda dhe jashtë bankës, sipas praktikave bankare dhe administrative.

## Sektori i Burimeve Njerëzore, ka këto detyra dhe funksione bazë:

- Planifikimin e burimeve njerëzore, në bazë të objektivave të institucionit, nevojave për burime njerëzore në etapa të afërta dhe në perspektivë; modelimin e karrierës së personelit në Bankën e Shqipërisë nëpërmjet miratimit të politikave eficiente për rotacionin në punë, në mbështetje të rezultateve të arritura nga punonjësit; rekrutimin në punë nëpërmjet politikave dhe procedurave konkurruese; seleksionimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve nëpërmjet procedurave standarde.
- Zhvillimin e punonjësve nëpërmjet hartimit të programeve dhe politikës së trainimit për kualifikim dhe për specializim për stafin drejtues dhe për personelin nëpunës; përdorimin e procedurave transparente në shpalljen e programeve trainuese për punonjësit e Bankës së Shqipërisë.
- Krijimin e mundësive të barabarta për punësim nëpërmjet sigurimit dhe krijimit të kushteve të njëjta për punësim, administrimin e veprimeve pozitive në punësimin e kandidatëve konkurrues, përpunimin e kërkesave dhe të ankesave të punonjësve me qëllim krijimin e mundësive të barabarta të punësimit dhe shmangien e diskriminimit në punë.
- Pagat dhe shpërblimet e tjera në favor të punonjësve, nëpërmjet zbatimit të politikave të pagave, përsosjes së vazhdueshme në përputhje me ndryshimet dhe me zhvillimin e aktivitetit të strukturës së pagave të punonjësve, zbatimin e politikave mbi pagat nxitëse e motivuese në përputhje me rrezultatet e arritura, trajtimin e shpërblimeve shtesë në favor të punonjësve.
- Analizën e punës, përshkrimin e punës dhe vlerësimin e punës, duke përdorur matësa standardë për rezultatet e punonjësve gjatë vitit ushtrimor si dhe përfitimin e shtesës mbi pagë nëpërmjet vlerësimit.
- Marrëdhëniet e punës nëpërmjet përgatitjes dhe mbikëqyrjes të negociatave në marrëdhëniet individuale të punës për punonjësit e emëruar; mbikëqyrjen dhe administrimin e masave disiplinore që akordohen nga eprorët për punonjësit që shkelin rregullat e punës, duke zbatuar për çdo rast procedura transparente.
- Hartimin dhe administrimin e politikave sociale të Bankës së Shqipërisë për krijimin e një mjedisi miqësor e motivues në ambientet e punës; trajtimin e problemeve për ruajtjen e shëndetit të punonjësve; përmirësimin e kushteve të banimit të tyre nëpërmjet dhënies së kredive për strehim etj..

Marrëdhëniet e burimeve njerëzore dhe ato juridike, për vetë natyrën e tyre, kërkojnë një zhvillim dhe përmirësim të vazhdueshëm. Për këtë arsye janë përcaktuar objektiva edhe më ambiciozë për të ardhmen.

Në fokus do të jetë përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit rregullator dhe ligjor me synim përafrimin me legjisllacionin e Bashkimit Europian dhe atë të Bankës Qendrore Europiane. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet legjisllacionit që organizon Bankën e Shqipërisë dhe sistemin bankar, këmbimet valutore; bashkëpunimit për përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e tatim-taksave si edhe në legjisllacionin civil në përgjithësi, për pjesët që ndikojnë në veprimtarinë bankare.

Përmirësimi i punës së Departamentit do të kërkojë edhe përshtatjen e strukturës së kësaj njësie me atë të Bankës Qendrore Europiane dhe të bankave anëtare të Sistemit të Bankave Qendrore Europiane. Kjo do të lejojë që të dy funksionet të zhvillohen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

Po kështu, në rishikim do të jenë struktura e pagave me qëllim racionalizimin e saj dhe lidhjen më të drejtpërdrejtë me rezultatet në punë të çdo individi. Kjo do të realizohet duke thjeshtuar sistemin e vlerësimit në punë dhe duke e kthyer atë në një matës sa më konkret të punës individuale, si dhe duke u shoqëruar me motivim më të përshtatshëm monetar e jomonetar.

Motivimi synohet të sigurohet edhe nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të projekteve për përmirësimin e kushteve fizike, psikologjike dhe teknologjike në bankë. Kujdesi për motivim dhe për vlerësim të duhur të punonjësve do të shoqërohet me rritje të cilësisë së punonjësve të punësuar rishtazi duke zbatuar procedura më të drejta e të ndershme si edhe duke rikonceptuar strategjinë e trajnimit të punonjësve.

Krijimi i vizioneve strategjike dhe përkushtimi për zbatimin e tyre si nga drejtuesit dhe nga punonjësit e bankës mendohet të sigurohet duke përmirësuar rolin e eprorëve direktë në administrimin dhe në zhvillimin e burimeve njerëzore; duke zhvilluar një rrugë të qartë të karriere për punonjësit në hierarkinë organizative të bankës qendrore dhe sidomos nëpërmjet reduktimit të ndryshimeve në strukturën organizative dhe në kuadrin rregullator brenda bankës gjë që deri më sot krijon mjedis të paqëndrueshëm dhe deri - diku çorientues.